



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE  
SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Gjeografi bërthamë

Varianti A

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

• *Pyetjet me zgjedhje*

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	D	A	A	C	B	C	A	C	A	B

• *Pyetjet me zhvillim*

**Pyetja 11**                      **3 pikë**  
**Përgjigje**

- Hartë topografike
- Lumi rrjedh më shpejt në pikën 1, pasi aty është pjerrësia më e madhe e relievit. Sa më të dendura të jenë izohipset aq më e madhe është pjerrësia e relievit.

**OSE**

- 3 pikë**                      Nëse përcakton llojin e hartës, pikën 1 dhe jep shpjegimin e duhur.
- 2 pikë**                      Nëse përcakton llojin e hartës dhe pikën 1 **OSE** përcakton pikën 1 dhe jep shpjegimin e duhur.
- 1 pikë**                      Nëse përcakton llojin e hartës **OSE** pikën 1.
- 0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

**Pyetja 12**                      **3 pikë****Model pergjigjeje**

- a) Faktorët kryesorë të formimit të baticave dhe zbaticave janë forca tërheqëse e Hënës dhe më pak e Diellit.
- b) Baticat më të mëdha i shkakton forca tërheqëse e Hënës. Hëna edhe pse është më e vogël se Dielli ka një efekt tërheqës më të madh, pasi ka një distancë më të vogël nga Toka.

- 3 pikë**                      Nëse përcakton saktë dy faktorët dhe bën shpjegimin e duhur
- 2 pikë**                      Nëse përcakton përcakton saktë dy faktorët OSE përcakton një nga faktorët dhe bën shpjegimin e saktë.
- 1 pikë**                      Nëse përcakton një nga faktorët.
- 0 pikë**                      Nëse shkruan thjesht Hëna OSE Dielli pa dhënë forcën tërheqëse të tyre.
- 0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare
- 

**Pyetja 13**                      **3 pikë****Model përgjigjeje**

Periudhës së pushtimit osman.

Dendësia e popullsisë është më e madhe në zonat fushore për shkak të tokave pjellore dhe klimës më të ngrohtë. Në këto zona njerëzit kanë gjetur kushte më të favorshme për jetesë.

- 3 pikë**                      Nëse shkruan saktë periudhën, shpjegon arsyen pse në zonat fushore dendësia është më e madhe
- OSE**
- 2 pikë**                      Nëse shkruan saktë periudhën, dhe identifikon se dendësia e popullimit është më e madhe në zonat fushore, pa dhënë shpjegimin **OSE** shpjegon saktë pse në zonat fushore dendësia është më e madhe
- 1 pikë**                      Nëse shkruan vetëm periudhën **OSE** identifikon se dendësia e popullimit është më e madhe, pa dhënë shpjegimin
- 0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare
- 


**Pyetja 14**                      **3 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Gjatë ditës, shkëmbinjtë ngrohen dhe bymehen, kurse natën, duke u ulur temperaturat, tkurren. Kjo përsëritje ngrohjeje e ftohjeje e si pasojë bymimi e tkurrja, prishin kompaktësinë e shkëmbit dhe ai zbërthehet në copëra, e thërrmija.
- b) Tjetërsimi fizik mbizotëron më tepër në zonat e thata e të nxehta dhe kur shkëmbinjtë janë të zhveshur nga bimësia. Në shkretëtira dhe gjysmëshkretëtirat ku gjatë 24 orëve luhatjet e temperaturave arrijnë deri në 60-70°C, procesi i tjetërsimit është shumë i fuqishëm.

- 3 pikë**                      Nëse shpjegon saktë pse ndodh tjetërsimi fizik për shkak të temperaturave dhe shkruan se në cilat zona mbizotëron ai.
- OSE**
- 2 pikë**                      Nëse bën shpjegimin e saktë të kërkesës së parë **OSE** bën shpjegim të pjesshëm të kërkesës së parë dhe bën saktë kërkesën e dytë
- 1 pikë**                      Nëse bën vetëm shpjegim të pjesshëm të kërkesës së parë **OSE** bën saktë kërkesën e dytë
- 0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare
-

**Pyetja 15** **3 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Figura 3 paraqet në mënyrë të saktë modelin e qarkullimit të ajrit.
- b) Ajri i ftohtë është më i rëndë ndërsa ajri i ngrohtë është më i lehtë. Për rrjedhojë ajri ftohtë ( $10^{\circ}\text{C}$ ) pasi futet brenda në shtëpi e ngre lart ajrin e ngrohtë ( $18^{\circ}\text{C}$ ) i cili del jashtë dritares së shtëpisë.(konveksioni termik)



**3 pikë** Nëse përcakton figurën 3 dhe bën shpjegimin e plotë.

**OSE**

**2 pikë** Nëse përcakton figurën 3 dhe bën shpjegimin e pjesshëm.

**1 pikë** Nëse përcakton figurën 3.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 16** **3 pikë****Model përgjigjeje**

Ngrohja globale, hollimi i shtresës së ozonit, ndotja e mjedisit, prerja e pyjeve pa kriter, rritja e shkallës së shkretirëzimit, sëmundjet pandemike etj.

Të gjitha këto probleme globale nuk mund të trajtohen në mënyrë të izoluar vetëm në disa vende, pasi zgjidhja e pjesshme nuk është e qëndrueshme dhe e plotë. (Është një problem që prek gjithë globin, në këtë mënyrë të gjitha shtetet duhet të marrin masa për minimizimin e problematikave të ndryshme)

**OSE**

Këto probleme quhen globale, pasi p.sh. ndotja apo sëmundjet pandemike nuk mund të kufizohen brenda kufijve të një shteti. Psh nëse një shtet ka industri të zhvilluar, kjo nuk do të thotë se ndotja e ajrit është prezente vetëm në atë shtet, por përhapet shumë më gjerë.

**3 pikë** Nëse përcakton njërin nga problemet globale dhe bën argumentimin e plotë

**OSE**

**2 pikë** Nëse përcakton njërin nga problemet globale dhe bën argumentimin e pjesshëm

**1 pikë** Nëse përcakton njërin nga problemet globale **OSE** bën argumentimin e pjesshëm

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

**Pyetja 17** **3 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Është deti më i thellë i Mesdheut.
- b) Valët arrijnë 3-3.5m lartësi.
- c) Amplituda mesatare e mareve është rreth 30cm.
- d) Ka ujëra të ngrohta.
- e) Ka kripësi të lartë (Kripësia shkon deri në 39%).
- f) Ka te dukshmëri të theksuar.
- g) Ka ngjyrë të kaltër të mbyllur.

**3 pikë** Nëse rendit tre nga veçoritë.

**OSE**

**2 pikë** Nëse rendit dy nga veçoritë.

**1 pikë** Nëse rendit një nga veçoritë.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 18**                      **3 pikë****Përgjigje:**

- Rajoni Verior-Verilindor: krom, bakër etj
- Rajoni Juglindor: hekur-nikel
- Rajoni Perëndimor: naftë, qymyrgur, gaz natyror.

**3 pikë**                      Nëse përcakton nga një pasuri minerare për secilin nga rajonet.

**OSE**

**2 pikë**                      Nëse përcakton nga një pasuri minerare për dy nga rajonet.

**1 pikë**                      Nëse përcakton nga një pasuri minerare për një nga rajonet.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 19**                      **3 pikë****Përgjigje:**

- Në veri: Vermoshi
- Në jug: Konispoli
- Në lindje: Fshati Vërnik i Devollit
- Në perëndim: Ishulli i Sazanit

**3 pikë**                      Nëse përcakton saktë tri nga pikat skajore.

**OSE**

**2 pikë**                      Nëse përcakton saktë dy nga pikat skajore.

**1 pikë**                      Nëse përcakton saktë një nga pikat skajore.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 20**                      **3 pikë**

- a) Pozita e favorshme gjeografike, duke zënë gjithë pjesën perëndimore më fushore të vendit, që është e favorshme për zhvillimin e degëve të ekonomisë.
- b) Dalja e gjerë në detin Adriatik, e cila favorizon zhvillimin e turizmi, tregtisë, peshkimit etj. Këtu gjenden portet më të rëndësishme të vendit.
- c) Mbizotërimi i relievit fushor, tokave pjellore, klimës tipike mesdhetare, pasurive të mëdha ujore, të cilat favorizojnë zhvillimin e bujqësisë, etj
- d) Rezervat e lëndëve djegëse të cilat favorizojnë zhvillimin e industrisë
- e) Përqendrimi në këtë rajon i potencialit human (numri i madh i popullsisë), qendrave më të mëdha urbane, ekonomike, që favorizojnë punësimin dhe zhvillimin.
- f) Mundësitë e komunikimit të këtij rajoni me gjithë rajonet e tjera të vendit etj.

**3 pikë**                      Nëse shpjegon saktë tre nga faktorët.

**OSE**

**2 pikë**                      Nëse shpjegon saktë dy nga faktorët.

**1 pikë**                      Nëse shpjegon saktë një nga faktorët.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

---